

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Çelet te Vila 31 ekspozita kushtuar grave të Ballkanit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/elet-te-vila-31-ekspozita-kushtuar-grave-te-ballkanit-i588467
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 07:21:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 07:17:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e31e0940fed31f52ae888d73f076f4d48cd48e98f079448941e8ace9b26d2b05
TEKSTI	c959cab95731f6e5c570f3220fd14b82b15e0b33b0337170fead17327c34a934
PAMJA	633ebc0cc5e7f335e1705bcd9e8d8044dfbea999edb3649cfaebaecbdf880b9c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e30126c33c7681fd6ab5c91d019bc8350d17ef97f561243183c62e3106be07e3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a38a4fa799b1e73bbabeaa0ef113694411dbd892b18eb619eb2f3db166512539
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e30126c33c7681fd6ab5c91d019bc8350d17ef97f561243183c62e3106be07e3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)



English



le [Sot ndeshja Shqiptari - Bjellorusi, policia publikon masat! Ja rruget qe do te bllokohen](#) Çelet te Vila 31 ekspozita kushtuar grave te Ballkanit [HE i kerkon Mbretetise se Bash](#)
fundit

Çelet te Vila 31 ekspozita kushtuar grave të Ballkanit



26 Shtator 2026, 09:17 Kulturë TEMA



Një ekspozitë dedikuar grave të Ballkanit dhe historive të tyre të jashtëzakonshme u çel mbrëmjen e kaluar në ambientet e Vilës 31.

Përmes fotove dhe videove të realizuara nga bashkëpunëtorët e AFP-së në Ballkan, këto gra të moshave dhe profesioneve të ndryshme rrëfejnë botën e tyre, nga miniera në atelie...

"Pas çdo fotoje ka një histori të këtyre grave, që janë bërë me forcën e punës së vetë dhe kanë ndikuar në komunitetin ku jetojmë. I kemi përzgjedhur në tre breza të ndryshëm dhe tre profesione krejt të ndryshme nga njëra-tjetra", tha fotografi Adnan Beci.

Për organizatorët, kjo ekspozitë lindi nga nevoja për të dëgjuar gratë e rajonit, për të parë përtej stereotipeve që pjesa tjetër e Europës u ka mveshur jetëve të tyre, për të çmontuar klishetë dhe për të zbuluar të vërtetat e tyre.

"Të gjithë ishim të një mendimi se zërat e grave të këtij rajoni duhet të dëgjohen! Dhe jo me fjalët tona, por me fjalët e tyre. Ndaj donim që secila prej tyre të regjonte historinë e vet. Kam parë te secila prej tyre që ka një fuqi të jashtëzakonshme për të luftuar stereotipet", tha Camille Bouissou.

Nga liria te pamja e jashtme, nga mëmësia te ekonomia, zërat e tyre ndërthuren për të vizatuar se çfarë do të thotë të jesh grua në Ballkan – dhe përtej tij. Ekspozita "Zëra të fuqishëm" – Gratë e Ballkanit – Forcë dhe trashëgimi do të qëndrojë e hapur në vilën e ish-diktatorit deri më 2 tetor. A.K./Tema



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Koka e humbur e Titos: ikonoklazëm politik apo betejë për narrativën post-socialiste](#)

21:07 Kulturë / 1 koment

Të rinjtë dhe fëmijët, pjesë e pandashme e TIFF

17:49 Kulturë

Blendi Gonxhe: Në Butrint po punohet çdo ditë për të ruajtur trashëgiminë

16:50 Kulturë

Lazari

16:49 Kulturë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.